

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, procesmbajtëse Ardijana Reshtani, në lenden penale kundër të akuzuarit L. D., nga fshati K. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 2023-1/2016 të datës 01.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Besim Susuri, dhe të akuzuarit, me date 08.09.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**L. D.**, nga i ati Y., dhe nëna Xh., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin K., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin, me profesion gjeodet, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës,

#### ËSHTË FAJTOR

Se me datën 31.07.2016, rreth orës 16,15 minuta, në rrugën ....., saktësisht të arritur në fshatin Korishe, duke mos iu permbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për Siguri në komunikacion Rrugor, në atë mënyrë që i pandehuri, duke drejtuar automjetin e markës "Audi B 4" me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë hiri, kur arrin në vendin kritik, nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur biqiklistit, tejkalimin e ka ndërmarrë në mënyrë të pasigurt dhe nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, edhe pse e ka vërejtur biqiklistin para tij dhe në momentin kur e ka ngritur dorën për kthim në anën e majtë, nuk arrin të ndal automjetin dhe e godet dhe biqiklistin S. A., derisa ishte duke u kthyer majtas, me të cilat vepime përpos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari S. A., lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor dr.F. D., të datës 20,10,2016,

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragraf 1 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.3, 46,73, 74,75 dhe 76 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 300 ( treqind ) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendsohet me denim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro,një ditë burg.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe ate në emër të ekspertizës të komunikacionit shumë prej 40,88 euro dhe ekspertizave mjekësore shumë prej 40,88 euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi,nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari: S. (F.) A. nga fshati L., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2023-1/2016 të datës 01.12.2016, kundër të akuzuarit L. D. , nga fshati K., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-ës,

Prokurori i shtetit Besim Susuri në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr.2023/2016 të datës 01.12.2016 kundër të akuzuarit L. D. nga fsh K., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 367 par. 6 lidhur me par. 1 të KP-ës dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bayuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqzrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari L. D. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj veprën penale e cila më vihet në barrë, është fakt që unë në ditën kritike kamë qarkulluar me automjetin e markës “Audi B 4”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, dhe atë në drejtim nga Prizreni për në Suharekë , me të arritur te rruga për në fshatin C., e kam vërejtur të dëmtuarin S. A., me biçikletën, që qarkullonte në të njëjtin drejtim, për skajë të rruges, dhe i njëjti në një moment ka dhënë shenjë me dorë për kthim në të majtë, kthimin e të cilit edhe e filloi, por pa shikuar fare qarkullimin e automjeteve në rrugë, ku isha duke qarkulluar edhe unë, andaj i njëjti me rastin e kthimit në të majtë, më doli përpara automjetit tim, i gjendur në një situatë të tillë të befasishme, kam tentuar që të shmang aksidentin, por edhe përkunder të gjitha veprimeve të ndërmarra në këtë veprim, me pjesën e skajshme të djathtë , tek sinjalizuesi i kthimeve e kam goditur biçiklistin, këtu të dëmtuarin. Duke pasur parasysh të cekurat më lartë, e pranoj veprën penale e cila më vihet në barrë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mia personale, moshën time të re, është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, më vije keq për rastin e ndodhur, kam qenë në spital për të vizituar të dëmtuarin, i cili pas ndihmës së parë të ofruar është

liruar për në shtëpi, po ashtu jamë përkujdesur edhe për shpenzimet e të nyltit, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 31.07.2016, rreth orës 16,15 minuta, në rrugën ....., saktësisht te arritur në fshatin Korishe, i akuzuari duke mos iu permbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për Siguri në komunikacion Rrugor, në atë mënyrë që i pandehuri, duke drejtuar automjetin e markës “Audi B 4” me targa të regjistrimit numri i targës..., ngjyrë hiri, kur arrin në vendin kritik, nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur biqiklistit, tejkalimin e ka ndërhyrë në mënyrë të pasigurt dhe nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, edhe pse e ka vërejtur biqiklistin para tij dhe në momentin kur e ka ngritur dorën për kthim në anën e majtë, nuk arrin të ndal automjetin dhe e godet dhe biqiklistin S. A., derisa ishte duke u kthyer majtas, me të cilat veprime përpos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari S. A., lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor dr.F. D., të datës 20.10.2016,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht, paraparakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, pendimin e tij të thellë për veprën penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 300 Euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se

me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2649/2016 me datë 08.09.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Ardijana Reshtani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.